REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtërues

AVOKATI I POPULLIT
Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/317
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I38-2 Prot. **Tiranë 30__/07___/2025**
Nr. Dok. 202502725/2

Lënda: *Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisariatin e Policisë Pukë.*

Drejtuar: **Z. Liman TOPALLI**
Shef i Komisariatit të Policisë

PUKË

Për dijeni: **Z. Fatmir LLESHAJ**
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

SHKODËR

Për dijeni: **Z. Ilir PRODA**
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim mbi gjetjet e inspektimit që Institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisariatin e Policisë Pukë më datë 08.05.2025.

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisariatin e Policisë Pukë, sipas një Plani Inspektimi vjetor të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Ahmet Prençi, Komisioner i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe z. Hazbi Selita me detyrë Nd/Komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave themelore të shoqëruarve/ndaluarve/arrestuarve, të cilat ju garantohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr.82/2024, "Për Policinë e Shtetit", aktet

nënligjore, si dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria në mjediset e policisë. Inspektimi ishte paparalajmëruar.

Gjithashtu, u verifikuan procedurat që ndjekin punonjësit e policisë në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurave standarde të punës *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë"*, si dhe zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin ligjor t'ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi inspektues u takua me shefin e Komisariatit të Policisë Pukë z. Liman Topalli, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Pasi u njoh me qëllimin e inspektimit, shefi i komisariatit informoi grupin e inspektimit në lidhje me kushtet në të cilat ndodhet ambienti i shoqërimit, angazhimin e punonjësve të policisë së këtij komisariati për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të personave të privuar nga liria në këto ambiente, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Grupi i inspektimit, i shoqëruar nga shefi i komisariatit, vijoi inspektimin në ambientet e shoqërimit të komisariatit, vizitoi zyrat e punonjësve të policisë dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar, si dhe këqyri e kontrolloi plotësimin sipas rubrikave të regjistrit ku evidentohen të dhënat e personave të shoqëruar/të ndaluar apo të arrestuar, librin e kërkesë/ankesave, regjistrin për të miturit në konflikt me ligjin, plotësimin e modelit të formularit të shoqërimit, si dhe ruajtjen dhe administrimin e kopjeve të procesverbaleve të shoqërimit.

Gjithashtu, z. Topalli angazhoi edhe punonjësit e policisë së ambienteve të shoqërimit të këtij institucioni që të ishin prezent për të bashkëpunuar dhe për të shërbyer në vijim të procesit të inspektimit. Grupi inspektues, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e inspektimit, vijoi takimin me punonjësin përgjegjës të dhomës së shoqërimit, që na u bashkua gjatë evidentimit të kushteve të ambienteve të Komisariatit të Policisë Pukë.

Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se gjendja faktike e ambientit të shoqërimit ishte e njëjtë si në inspektimin e mëparshëm, krahasuar me standardet e parashikuara në aktet normative dhe aktet ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, të ndaluar/arrestuar brenda këtyre ambienteve.

Shefi i komisariatit dhe punonjësit e Komisariatit të Policisë Pukë, me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues gjatë zhvillimit të inspektimit.

Në Komisariatin e Policisë Pukë, nga informacioni i grumbulluar gjatë kryerjes së inspektimit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve[1] të Institucionit të Avokatit të Popullit rezultoi se:

1. Ishte zbatuar rekomandimi për plotësimin e regjistrit të shoqërimit sipas rubrikave në përputhje me procedurat standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*", miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Ishte zbatuar rekomandimi për mirëmbajtjen dhe garantimin e kushteve higjieno-sanitare në ambientet e Komisariatit të Policisë Pukë, si dhe lyerjen dhe dezinfektimin e vazhdueshëm të tyre.

3. Ishte zbatuar rekomandimi për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.

4. Ishte zbatuar pjesërisht rekomadimi për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në korridorin e institucionit, **por jo** në ambientin e dhomës së shoqërimit në Komisariatin e Policisë Pukë.

Ndërkohë, nga inspektimi rezultoi se:

5. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për gjetjen e fondeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për të mundësuar rikonstruksionin e përgjithshëm të godinës së Komisaritit të Policisë Pukë, me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjtoze, si për personat e shoqëruar, ashtu edhe për të garantuar kushte të përshtatshme pune për punonjësit e policisë së këtij institucioni.

6. Nuk ishte zbatuar rekomandimi për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Pukë, sipas kritereve të parashikuara në Kreun VI, pika 4 të procedurave standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*", miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit duke përfshirë në të, ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur në konflikt me ligjin.

7. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin e dhomës për mbajtjen e provave materiale dhe largimin nga zyrat e punës së oficerëve të Policisë Gjyqësore të sendeve të cilat mund të ekspozojnë dhunë psikologjike/fizike tek personat me të cilët ata kryejnë veprime procedurale.

8. Nuk ishte zbatuar rekomandimi për krijimin e një ambienti të përshtatshëm për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion, si dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës të punonjësve të policisë të komisariatit.

[1] *"Rekomandim për inspektimin e kryer në ambientin e shoqërimit të Komisariatit të Policisë Pukë".*

9. Nuk ishte zbatuar rekomandimi për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.

10. Nuk ishte zbatuar rekomandimi për ndërtimin e tualeteve të ndara për femra dhe për meshkuj, si dhe pajisjen e tyre me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të Komisariatit të Policisë Pukë.

Në përfundim, grupi i inspektimit konstatoi se në Komisariatin e Policisë Pukë ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me garantimin e të drejtave ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, por vazhdonin të ishin të pranishme edhe disa problematika, të cilat po i parashtrojmë më poshtë:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisariatin e Policisë Pukë, ambienti i shoqërimit **nuk** ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr. 82/2024, "Për Policinë e Shtetit", dhe procedurave standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë"*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për persona të rritur, për femra dhe të miturit[2].

Komisariati i Policisë Pukë funksiononte në një godinë të vjetër dhe të amortizuar. Ambienti i shoqërimit ishte në katin e dytë të godinës dhe përbëhej nga **1 (një) dhomë shoqërimi,** e cila ishte përshtatur brenda ambienteve të godinës së institucionit dhe ishte sipas kritereve të parashikuara në procedurat standarde "*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*", miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ajo përdorej për meshkujt madhorë, ndërkohë **që nuk kishte dhomë për shoqërimin e grave dhe të miturve**.

Mungesa e dhomave të shoqërimit për gratë dhe të miturit[3] në konflikt me ligjin është një problem thelbësor që paraqitet në këtë komisariat, duke mos siguruar garantimin e lirive, të drejtave dhe standardeve që kanë të bëjnë me shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin në mjediset e policisë, si dhe nevojave fizike dhe psikologjike, kur merren vendime që prekin ndonjë aspekt të ndalimit të tyre.

Për shoqërimin e grave dhe të miturve përdorej ambienti i pritjes në hyrje të këtij komisariati ose personat qëndronin në një ambient të hapur në oborrin e jashtëm të institucionit në mungesë të dhomave të përshtatshme.

Dhoma e shoqërimit ishte me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve, e pajisur me stola për të mundësuar qëndrimin ulur të personave, por mungonte tavolina për të qenë një ambient sa më kreativ. Përmasat e

[2] Kreu VI, pika 4/e.1 e procedurave standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë"*, ku thuhet se: *"Në njësitë Vendore të Policisë ndërtohen ambientet e shoqërimit të ndara më vete për personat madhorë, të mitur dhe femra, të cilat kanë sipërfaqe 16-20m2".*

[3] Kreu VI, pika 4 e procedurave standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë",* ku parashikohet se*: "Dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për gra, meshkujt madhorë dhe të miturit".*

dhomave të shoqërimit ishin 4x4m me kapacitet për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri 4 persona.

Dhoma e shoqërimit kishte dritare, përmasat e së cilave siguronin ndriçim të nevojshëm natyral. Dhomat gjithashtu, kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Dera ishte prej druri, me mundësi për t'u mbyllur nga jashtë.

Në ambientet e dhomave të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Pukë kishte sistem ngrohje/ftohjeje, me anë të kondicionimit sikurse parashikohet në procedurat standarde.

Në korridorin e ambientit të shoqërimit ndodhej vetëm një tualet, me sipërfaqe të mjaftueshme dhe i kompletuar me lavaman e rubinet për ujin, si dhe me pajisjet e nevojshme hidrosanitare. Ambientet e brendshme furnizohen me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje nga rrjeti i UK Pukë. Në ambientet e këtij komisariati mungonte tualeti për gra, duke mos garantuar standardin e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 për miratimin e procedurave standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë"*[4].

Në korridorin e dhomës së shoqërimit ishte e instaluar 1 kamera për mbajtjen në vëzhgim të këtij ambienti, por mungonte kamera brenda dhomës së shoqërimit për monitorimin e personave të shoqëruar në këtë insitucion. Instalimi i sistemit të kamerave të sigurisë brenda dhomave të shoqërimit do të shërbejë për mbajtjen në vëzhgim të dhomës së shoqërimit, si dhe do të monitorojë veprimet që kryejnë punonjësit e policisë me personat e shoqëruar gjatë kryerjes së procedurave që nga hyrja në mjediset e policisë, qëndrimi në dhoma, si dhe gjatë marrjes në pyetje të tyre.

Në kushtet e vendndodhjes së komisariatit, si dhe për të garantuar sigurinë e personave të shoqëruar, është i domosdoshëm instalimi i sistemit të kamerave në ambientet e brendshme të dhomave të shoqërimit siç parashikon Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 procedurat standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë"*, ku thuhet se: *"Të gjitha ambientet e shoqërimit monitorohen me sisteme të kamerave (përjashto tualetin), si ambientet e brendshme të dhomave të shoqërimit, korridori i tyre dhe pjesa e jashtme e dhomave të shoqërimit, të cilat lidhen dhe trasmentojnë pamje/imazhe në monitor të vendosur në ambientin e shoqërimit të sallës së komandimit/shërbimit të informacionit DPV komisariate, stacione policie".*

Në Komisariatin e Policisë Pukë, gjatë periudhës 01.01.2025 deri më 08.05.2025 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **26** persona, ku të 26 personat ishin shtetas meshkuj madhorë të shoqëruar në konflikt me ligjin, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 19 dhe 25 të ligjit nr. 82/2024, "Për Policinë e Shtetit". Në momentin e inspektimit, **nuk kishte asnjë shtetas** të shoqëruar në dhomën e shoqërimit.

Në ambientin e shoqërimit ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar. Gjithashtu, në posterat përkatës ishte pasqyruar edhe e drejta ligjore e personave të shoqëruar për të paraqitur ankesa.

[4] Kreu VI, pika 4 e procedurave standarde "*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*" ku përcaktohet se: *"Brenda këtyre ambienteve ose ngjitur me to, të ketë tualete, të ndara për femra dhe meshkuj, të pajisura me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim".*

Gjithashtu, na u bë me dije se personat e shoqëruar nga policia janë informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë. Përveç sa më sipër, Avokati i Popullit inkurajon pajisjen e qytetarëve me *"Kartën e të Drejtave"* në rast shoqërimi në polici, që është një dokument me të cilin duhet të njihet çdo qytetar që shoqërohet në një komisariat policie. Nëpërmjet *"Kartës së të Drejtave"* qytetari informohet mbi të drejtat e tij përballë institucionit të Policisë së Shtetit në mënyrë që të jetë i ndërgjegjshëm për çdo formë abuzimi apo tejkalimi të kompetencave të punonjësve të policisë kundrejt tij.

Vendosja në dispozicion të çdo qytetari të *"Kartës së të Drejtave"* është një standard të cilin Avokati i Popullit kërkon vazhdimisht që të respektohet. Gjithashtu edhe Komiteti për Parandalimin e Torturës CPT[5]-ja, përshëndeti zhvillimin e kësaj praktike për kartën edhe thellimin e saj, duke kërkuar që punonjësit në zyrën e pranimit të sigurohen që të shoqëruarit që shkruajnë e lexojnë, e kuptojnë përmbajtjen e kartës së të drejtave.

Sipas strukturës, Komisariati i Policisë Pukë kishte në organikë 3 specialistë policie/OPGJ dhe 6 specialistë SPZ. Nga këqyrja e zyrave të specialistëve të policisë/OPGJ dhe ndihmës/specialistëve të policisë/SPZ, nuk u gjetën sende apo mjete, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/merren në pyetje në zyrat e tyre.

Marrja në pyetje dhe intervistimi i personave të shoqëruar, në mungesë të një ambienti më vete, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Gjatë inspektimit nuk u konstatua asnjë rast, apo u administrua ndonjë ankesë lidhur me ushtrim dhune apo trajtim degradues nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit. Gjatë inspektimit u këqyrën 4 zyrat e oficerëve të Policisë Gjyqësore në ambientet e komisariatit. Këto ambiente ishin të pajisura me tavolina, karrige dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, si dhe me orenditë e nevojshme si karrige dhe tavolina pune për specialistët e policisë, por nuk kishte të instaluara kamerat e monitorimit.

Në Komisariatin e Policisë Pukë mungonte dhoma e mbajtjes së provave materiale, dhe në mungesë të saj oficerët e Policisë Gjyqësore, sendet të cilat mund të ekspozojnë dhunë psikologjike/fizike tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale i mbanin në zyrat e tyre[6].

Nga verifikimi i regjistrit të marrjes dhe dorëzimit të personave të shoqëruar, si dhe kopjeve të procesverbalit të veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar, në rubrikën me shënimet në lidhje me ankesat/kërkesat e të shoqëruarve rezultoi se, për vitin 2025 nuk kishte asnjë ankesë të regjistruar.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

[5] CPT u bën thirrje autoriteteve shqiptare të ndërmarrin hapa për të siguruar që personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë (domethënë, nga momenti kur ata janë të detyruar të qëndrojnë në polici). Kjo duhet të sigurohet me dhënien e informacionit të qartë verbal që në fillim, për t'u plotësuar në rastin më të shpejtë (domethënë, menjëherë pas mbërritjes në ambientet e policisë) me sigurimin e fletës së informacionit të lartpërmendur. Personave në fjalë duhet t'u kërkohet të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se ata kanë marrë një kopje të fletës së informacionit. Raporti CPT-së për Shqipërinë CPT/Inf (2019) 28 [par.24]. Konsulto: https://rm.coe.int/168097986b.
[6] Neni 215 i Kodit të Procedurës Penale *"Vulosja e sendeve të sekuestruara".*

Në Komisariatin e Policisë Pukë nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar, në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë, dërgoheshin menjëherë në dhomat e sigurisë të Komisariatit të Policisë Shkodër.

Regjistri i personave të shoqëruar, të ndaluar/të arrestuar dhe evidentimi i tyre

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisariatin e Policisë Pukë, "*Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar*" ishte i tipit "*Model nr. 1*" konform me procedurat standarde "*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*" miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 82/2024, "Për Policinë e Shtetit", regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme **nga 1 orë deri në 5 orë** në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë në zyrën e informacionit[7] dhe regjistri ishte i sekretuar.

Në këtë komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 24 të ligjit nr. 82/2024, "Për Policinë e Shtetit", por gjatë vitit 2025 nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë nga ana e këtyre personave.

Gjithashtu, në këtë institucion administrohej regjistër për të miturit e shoqëruar në konflikt me ligjin[8], ku evidentoheshin të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente, në të cilin u konstatua se të gjithë rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte dhe regjistri ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se gjatë vitit 2025 **nuk** kishte të shoqëruar të mitur në konflikt me ligjin.

"Formulari i Raportit të Shoqërimit" plotësohej gjithashtu nga punonjësi i policisë që kishte kryer shoqërimin e personit për në komisariat, sikurse përcaktohet në procedurën standarde.

Gjithashtu, *"Procesverbali me veprimet e kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar"*, në përfundim të veprimeve, kur shtetasi lihej i lirë, punonjësi i policisë e plotësonte atë në dy kopje, ku një kopje i jepej personit të shoqëruar, ndërsa kopja tjetër e procesverbalit, pasi administrohej nga punonjësi i informacionit, mbahej në dosje të veçantë dhe pas një jave dorëzohej në sekretarinë/arshivën e institucionit.

Në zyrën e informacionit, ndodhej edhe një regjistër për takimet me avokatin kur kërkohej nga të shoqëruarit, si dhe karta e të drejtave të personave të shoqëruar apo ndaluar/arrestuar në gjuhën shqipe dhe në disa gjuhë të huaja.

Ambientet e intervistimit

[7] Kreu VII, të procedurave standarde "*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*".
[8] Detyrim i përcaktuar nga ligji nr. 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur".

Në Komisariatin e Policisë Pukë oficerët e Policisë Gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre. Këto zyra **nuk ishin të monitoruara** dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e Policisë Gjyqësore[9].

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të veçanta për marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e Policisë Gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse u përshkrua edhe më sipër, ky rekomandim nuk është zbatuar ende.

Ky standard ka gjetur rregullim tashmë edhe në procedurat standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë"*, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke u shndërruar në rregull të detyruar për strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit. Në këtë dokument shprehet qartë se, në mjedisin ku ndodhen dhomat e shoqërimit, duhet të krijohet dhe një dhomë për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar para se të akomodohen/futen në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë (personat që do të arrestohen/ndalohen). Ky ambient përveç kushteve të përcaktuara për dhomat e shoqërimit duhet të plotësojë dhe kushtet për: *"Instalimin e sistemeve dhe pajisjeve për regjistrimin elektronik audio dhe video të të gjitha veprimeve procedurale që kryhen me personin e shoqëruar nga oficerët e Policisë Gjyqësore, para se personi të akomodohet në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë si i arrestuar/ndaluar"*[10]. Dokumentimi elektronik i intervistimit të personave të shoqëruar është një masë tepër efikase për parandalimin e dhunës psikologjike.

Gjithashtu në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e CPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit[11] ku citohet se: "*Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave që janë keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtime fizike apo presione psikologjike.*

Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare".

---

[9] Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim. Po ashtu, kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë e bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste." Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20]

[10] Kreu VI, pika 4/i.1.1 e procedurave standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë".*

[11] Electronic recording of police intervieës (Regjistrimi elektronik i marrjes në pyetje nga ana e policisë) fq,13, https://rm.coe.int/1680ae233b.

CPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të ndaluar.

Komisariati i Policisë Pukë në kushtet aktuale nuk posedonte hapësirë të posaçme për biseda apo intervistim me persona të mitur. MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohet traumatizim plotësues tek fëmijët.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Nga komunikimi me punonjësit e policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

Punonjësit e policisë informuan grupin e inspektimit se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me shkollat e mesme të qytetit të Pukës. Gjatë verifikimit të regjistrave të personave të shoqëruar u konstatua se procedura e ndjekur nga punonjësit e Komisariatit të Policisë Pukë ishte zhvilluar konform ligjit.

Sipas informacionit, përgjithësisht avokati paraqitej në mjediset e policisë jo më vonë se 1 orë nga momenti i njoftimit nga personeli i shërbimit ose nga specialistët e policisë të ngarkuar për kryerjen e veprimeve procedurale me të shoqëruarin apo të arrestuarin e dyshuar për kryerjen e veprës penale. Në regjistrin ku evidentohen takimet e të shoqëruarve me avokatin mbrojtës, shënohej emri dhe mbiemri i avokatit, si dhe ora e takimit, por jo ora e njoftimit.

Përsa më sipër, CPT ka rekomanduar që: *"Autoritetet shqiptare duhet t'u kujtojnë të gjithë oficerëve të policisë* ***detyrimin ligjor për t'i dhënë akses ndaj një avokati që nga fillimi i heqjes së lirisë së një personi****. Gjithashtu, duhet të ndërmerren hapa në konsultim me Dhomën e Avokatëve për t'u siguruar që avokatëve kryesisht t'u kujtohet* ***roli i tyre kyç në parandalimin e keqtrajtimit duke qenë të pranishëm në komisariatet e policisë*** *dhe duke ndërhyrë që në fillim të privimit të lirisë, duke përfaqësuar sa më mirë të munden interesat e personave që janë të mandatuar të ndihmojnë dhe, më konkretisht, duke ndërmarrë veprimet e duhura sa herë që ka tregues se persona të tillë janë keqtrajtuar (ose mund të jenë) keqtrajtuar nga policia. Gjithashtu, duhet të ndërmerren hapa për të promovuar, në kuadrin e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm të avokatëve, një kulturë ku* ***mosndjekja e akuzave për keqtrajtim policor të konsiderohet si joetike dhe joprofesionale****"*[12].

Në rastet kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, ata i shoqërojnë në Qendrën Shëndetësore Pukë, për të marrë ndihmën mjekësore.

Gjatë inspektimit, u konstatua se në këtë komisariat zbatohej detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 19/5 dhe 25/5 të ligjit nr. 82/2024, "Për Policinë e Shtetit", si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të

[12] *efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://rm.coe.int/1680ae233b*

veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t'i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar "*Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit*".

Gjatë inspektimit u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme, ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë, mbaheshin procesverbalet përkatëse, një kopje e të cilit firmosej dhe i jepej personit të shoqëruar.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*" dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*",

R E K O M A N D O J M Ë :

1. Marrjen e masave të nevojshme, për gjetjen e fondeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për të mundësuar rikonstruksionin e përgjithshëm të godinës së Komisaritit të Policisë Pukë, me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjtoze, si për personat e shoqëruar, ashtu edhe për të garantuar kushte të përshtatshme pune për punonjësit e policisë së këtij institucioni.

2. Marrjen e masave të nevojshme, për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Pukë, sipas kritereve të parashikuara në Kreun VI, pika 4 të procedurave standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*", miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit duke përfshirë në të, ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, duke parashikuar përshtatjen e dhomave sipas kushteve për jetesë, dhe të pajisura me orenditë e nevojshme dhe të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur në konflikt me ligjin.

3. Marrjen e masave të menjëhershme, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese brenda ambientit të dhomës së shoqërimit në Komisariatin e Policisë Pukë

4. Marrjen e masave të menjëhershme, për krijimin e një ambienti të përshtatshëm për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion, si dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës të punonjësve të policisë të komisariatit.

5. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.

6. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e dhomës për mbajtjen e provave materiale dhe largimin nga zyrat e punës së oficerëve të Policisë Gjyqësore të sendeve të cilat mund të ekspozojnë dhunë psikologjike/fizike tek personat me të cilët ata kryejnë veprime procedurale.

7. Marrjen e masave të nevojshme, për ndërtimin e tualeteve të ndara për femra dhe për meshkuj, si dhe pajisjen e tyre me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të Komisariatit të Policisë Pukë.

8. Marrjen e masave të nevojshme, për pajisjen e dhomës së shoqërimit me orenditë e nevojshme si tavolinë, që shërbejnë për shtetasit e shoqëruar, të cilat duhet të jenë të fiksuara në dysheme dhe të pa lëvizshme, sikurse përcaktohet në procedurat standarde.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtyre rekomandimeve, kërkojmë të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)

Ahmet PRENÇI

d.v